



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:020052
Datë: 29.01.2025
Numri i dokumentit: 06774545

Rev.nr.584/24

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Milena Gjeriq dhe Beshir Islami, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësve: R.G., Sh. G., B. G., N. G., H.G., E. G., A.G., L. G. dhe B2.G., të gjithë nga O., rr. ..., të cilët i përfaqëson Sadije Mjekiqi, avokate në Prishtinë, sipas autorizimit, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson përfaqësuesja e autorizuar Sh. M., sipas autorizimit, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.7713/21, të datës 10.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 23.01.2025 mori këtë:

A K T V E N D I M

Pranohet revizioni i paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), me seli në Prishtinë, Prishen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.7713/21, i datës 10.06.2024, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.3357/12, i datës 02.02.2020, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.3357/12, të datës 02.02.2021, është vendosur: I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve: R.G., Sh. G., B. G., N. G., H.G., E. G., A.G., L. G. dhe B2.G., të gjithë nga O. II. Detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a., me seli në Prishtinë, që paditësve në emër të kompensimit të dëmit për shkak të rrjedhjes së ujërave të ndotura nëpër paluajtshmëritë e tyre të cilat evidentohen si ngastra kadastrale ... me kulturë arë me sip....m² dhe ngastrën .me kulturë arë me sip. ... ZK O., t'ia kompensojë fitimin e humbur për shkak të pamundësisë së

shfrytëzimit të tokës për periudhën kohore prej ... në shumë prej 18,395 €, me kamatë ligjore ashtu që prej datës 01.01.2010 deri më datë 31.12.2012 si për mjetet e deponuara për një vit në bankat komerciale pa destinim të caktuar, kurse prej datës 01.01.2013, e deri në pagesën definitive kamatën prej 8%, e cila fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit. III. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë që ka të bëjë me fitimin e humbur për shkak të pamundësisë së shfrytëzimit për bujqësi të ngastrës kadastrale ... me kulturë livadh me sip....m², ZK O., në shumë prej 522 €, refuzohet si e pabazuar. IV. Obligohet e paditura që paditësve t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë prej 3038 €.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.7713/21, të datës 10.06.2024, është vendosur: I. Refuzohet e pathemeltë ankesa e të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a., me seli në Prishtinë, ndërsa pika I (një), II (dy) dhe III (tre) e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3357/12, të datës 02.02.2021, vërtetohet. II. Pika III (tre), e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3357/12, të datës 02.02.2021, mbetet e pa shqyrtuar.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion e paditura, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë, të aprovojë revizionin, duke e ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë ose çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në revizion kanë parashtruar paditësit me të cilën kanë kërkuar nga gjykata që të refuzoj revizionin e të paditurës dhe aktgjykimin e kontestuar ta vërtetojë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215, gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit kanë paraqitur padi në gjykatën e shkallës së parë, me datë 21.12.2012, kundër të paditurës, për shkak të kompensimit të dëmit, me arsye sikurse në padi, dhe të precizuar në seancën e shqyrtimit kryesor, të datës 21.10.2020.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditësve dhe pas shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.3357/12, të datës 02.02.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera ka theksuar se duke vepruar sipas padisë së paditësit, në procedurën e provave ka administruar këto prova: Certifikatën e Pronësisë UL-..., së bashku me të dhënat bazë për njësi për paluajtshmëritë ..., Certifikatën e Pronës UL-..., së bashku me të dhënat bazë për njësi për paluajtshmëritë ..., Certifikatën e Pronës ..., së bashku me kopjet e planit, Ekspertizën e gjeodezisë të datës 18.03.2020, të ekspertit Q. H., Raportin e vlerësimit për fitimin e humbur nga eksperti A. S. të datës 22.06.2020, Ekspertizën e

hidrologjisë të ekspertit A. Gj. të muajit qershor 2019, Certifikatën e Pronësisë për njësinë kadastrale ... ZK O., së bashku me kopjen e planit dhe për njësinë kadastrale

Ka shtuar se në këtë çështje juridike nuk ishte kontestues fakti se paditësit janë pronar të ngastrave kadastrale nr. ..., ... , fakt ky i cili është vërtetuar edhe nga certifikata e pronësisë. Kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ka qenë nëse e paditura KEK për shkak të devijimit - dëmtimit të shtratit të lumit "...", për shkak të derdhjes së ujërave të zeza, i shkakton dëm paditësve në pamundësimin e shfrytëzimit të pronës së tyre për bujqësi si dhe lartësia e dëmit të shkaktuar për shkak të fitimit të humbur.

Gjykata vërtetimin e gjendjes faktike në terren, e ka bërë me ndihmën e ekspertit të gjeodezisë, i cili në mendimin dhe konstatimin e tij detajisht ka përshkruar matjet gjeodezike dhe kufijtë e këtyre ngastrave, të cilat gjykata nuk i elaboroj në arsyetim pasi që të njëjtat nuk ishin kontestuese (më gjerësisht si në ekspertizë). Ka shtuar se, eksperti ka konstatuar se e paditura KEK, në shkresat e lëndës nuk ka prezantuar dëshmi mbi hapjen e kanalit nëpër ngastrën kadastrale nr. ... ZK O., dhe as nuk kanë prezantuar prova se është përfshirë në eksproprijim. Nga evidencat kadastrale vërehet se Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenci" Sh.A., nuk ka kryer ndonjë eksproprijim ngase në elaboratin kadastral vërehet se sipërfaqja e kësaj ngastre ... ZK O., nuk ka pësuar ndryshime. Eksperti ka konstatuar se me ndërtimin e kanalit për derdhjen e ujërave të bardha, vërehet se ky kanal nuk është i paraqitur në planet kadastrale dhe se sipas evidencës kadastrale as sipërfaqja e ngastrës kadastrale nr.... nuk ka pësuar ndryshime. Ngastra kadastrale ... ZK O., në sipërfaqe S=..., nuk kishte rrjedhje të ujit nga TC Kosova A, mirëpo ka mbushje me ujë dhe hedhje të mbeturinave, ngastra kadastrale ... ZK O., në sipërfaqe S=..., sipas gjendjes faktike nuk ka rrjedhje të ujit nga kanali i Termocentralit "Kosova A", por sipas gjendjes faktike ka mbushje dhe hedhje të mbeturinave kurse sa i përket ngastrës kadastrale ZK, O., në sipërfaqe S=..., nuk ka të bëjë me derdhjen e ujërave nga "Kosova A", por kjo ngastër është në kufi me një kanal të vjetër i cili evidentohet: P. Sh. Ujrat, K. K. Obiliq.

Gjykata e shkallës së parë ka shtuar se bazën juridike të kërkesëpadisë, respektivisht përcaktimin e shkaktarit të dëmeve eventuale në paluajtshmëritë e paditësve - për shkak të derdhjes së ujërave të zeza të Termocentralit Kosova A, e ka vërtetuar me ekspertizën e ujërave, të përpiluar me shkrim në qershor 2019. Eksperti ka konstatuar se mosmirëmbajtja e kanalit në gjendje që mundëson largimin e ujërave nga procesi teknologjik pa dalë jashtë tij ka pasojë daljen e ujërave jashtë kanalit dhe përhapjen dhe qëndrimin e ujit në sipërfaqe, pronë e paditësve që pamundëson shfrytëzimin e tyre për prodhimtari bujqësore, pra me kapacitet hidraulik të mjaftueshëm. Sipas ekspertit e paditura KEK, është shkaktar i dëmit të shkaktuar ngastrave të paditësve meqë ujërat e përdorura nga procesi i përgatitjes kimike të ujit (PPK) që formohen në procesin e përgatitjes së ujit të dekarbonizuar, demineralizuar dhe të zbutur të cilat janë në procesin e prodhimit të energjisë, largohen përmes kanalit të dheut në drejtim të ujë rrjedhës së "...", përmes kanalit të dheut i cili nuk mirëmbahet.

Ndërsa, lartësinë e fitimit të humbur, gjykata e ka vërtetuar sipas ekspertizës së bujqësisë të datës 22.06.2020, i cili e ka bërë llogaritjen e fitimit të humbur për periudhën kontestuese 2010-2020, të ngastrave kontestuese.

Nga gjendja faktike e vërtetuar, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se e paditura me veprimet e saj, respektivisht për shkak të mosmirëmbajtjes së kanalit të ashtuquajtur të “ujërave të bardha” të TC Kosova A, ngastrat kadastrale nr. ... dhe ..., pronë e paditësve, përfshihen nga të ashtuquajturat “shirat acidik”, duke i shkaktuar dëm paditësve në pamundësimin e shfrytëzimit të tokës për të mbjellat bujqësore. Këtë fakt gjykata e ka vërtetuar mbi bazën e ekspertizës së hidrologjisë, të cilës gjykata në tërësi ia ka fal besimin, si provë vendimtare në ndriçimin e fakteve kontestuese. Për të ndriçuar plotësisht gjendjen e fakteve, eksperti i hidrologjisë, në seancë gjyqësore ka sqaruar rrethanën e shkakimit të dëmit nga rrjedhja e “ujërave të bardha”, ku ka sqaruar se për nevoja të veta e paditura shumë vite më parë e ka devijuar shtratin e lumit dhe punimet të cilat i kanë zhvilluar, i kanë zhvilluar pa projekt, rrjedhimisht ka ndryshuar regjimi ujqor ashtu që tani rrjedha e lumit është më afër pronave të paditësve e nga kjo edhe kanali nga ujërat e bardha kalon kah objektet e Kosovës A, deri te “...”. Ky kanal nuk i plotëson kushtet hidroteknike, nuk përmbahet nga e paditura dhe si në fotot të cilat janë bashkangjitur në ekspertizë dëshmojnë se si pasojë e këtyre lëshimeve pronat përmythen. Për shkak të këtyre lëshimeve këto ujëra të përmytura mbesin aty dhe nuk kanë dalje në S. .

Lidhur me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë ka theksuar se: duke marr parasysh faktin se nga ekspertiza e gjeodezisë rrjedh se ngastrat kadastrale nr. ..., nuk ka të bëjë me derdhjen e ujërave nga Kosova A, por kjo ngastër është në kufi me një kanal të vjetër, andaj gjykata gjeti se kërkesëpadia që ka të bëjë me fitimin e humbur është e pabazuar. Kjo për faktin se siç ka konstatuar eksperti i gjeodezisë, përmytja eventuale e kësaj ngastre nuk i ka të bëjë me ujërat e bardha të paditurës, por nga ujërat e kanalit, për të cilën e paditura KEK, nuk mund të mbahet përgjegjëse. Në këtë drejtim, gjykata nuk e mori parasysh ekspertizën e hidrologjisë dhe atë të bujqësisë që kanë të bëjnë me vlerësimin e kësaj ngastre kadastrale.

Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave nga neni 154 dhe 185 të LMD-së (të vitit 1978). Për kamatën ka vendosur në bazë të nenit 277 të LMD-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes ka vlerësuar se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala e paditur me ankesë.

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga 182 paragraf 2 pika n) e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi themelësinë e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi themelësinë e pjeshme të kërkesëpadisë.

Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet e palëve duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara duke e vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, tani për tani nuk mund të pranohet përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë dhe as të dytë, edhe për faktin se gjykata e shkallës së parë, gjatë shqyrtimit gjyqësor, me provat e administruara nuk ka arritur që ta vërteton në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, rreth konstatimit dhe të provuarit të fakteve sipas pretendimeve nga padia, për arsye se gjykata e shkallës së parë ka dështuar të vërtetoj faktet me rëndësi për të vendosur sipas kërkesëpadisë të paditësve, për arsye se: nëse i referohemi pretendimeve të palëve dhe shkresave të lëndës rezulton se paditësit si pronar të ngastrave kadastrale ..., ... dhe ... , Zona Kadastrale O., kërkojnë kompensimin e dëmit për shkak të rrjedhjes së ujërave të ndotura nëpër paluajtshmëritë e tyre dhe fitimin e humbur, për periudhën ..., dëm ky që pretendohet të jetë shkaktuar nga e paditura Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), me rastin e vendosjes së hirit të qymyrit në pjesët ku kanë ngushtuar shtratin e lumit "S.", dhe një përroi që bartë ujërat e zeza të O., ndërsa e paditura e konteston në tërësi një pretendim të tillë si për nga baza juridike ashtu edhe për nga lartësia e kompensimit.

Gjykata e shkallës së parë fillimisht ka dështuar të vërtetoj bazën juridike të kërkesëpadisë, përkatësisht përgjegjësisë së të paditurës në raport me dëmin e shkaktuar, ndërsa gjykata e shkallës së dytë ka dështuar të jap përgjigje përkritazi me pretendimet ankimore të paditurës, të

njëjtat i ka trajtuar në mënyrë sipërfaqësore dhe pa mbështetje në ndonjë bazë të qëndrueshme ligjore.

Bazën juridike të kërkesëpadisë, përkatësisht përgjegjësinë e të paditurës, gjykata vlerëson se e ka vërtetuar nga ekspertiza e hidrologjisë, e cila ekspertizë sipas vlerësimit të kësaj gjykate përveç se është e mangët në drejtim të vërtetimit të bazës juridike-përgjegjësisë së të paditurës dhe fakteve vendimtare, është edhe kundërthënëse me vetveten, me ekspertizën gjeodezike dhe me provat materiale. Kështu, eksperti i ujërave ka konstatuar se: mosmirëmbajtja e kanalit të dheut në drejtim të rrjedhës së S., në gjendje që mundëson largimin e ujërave nga procesi teknologjik pa dalë jashtë tij ka pasojë daljen e ujërave jashtë kanalit dhe përhapjen dhe qëndrimin e ujit në sipërfaqen, pronë e paditësve, po ashtu edhe afërsia e tokave të paditësve me kapacitetet termoenergjetike të Korporatës Elektroenergjetike të Kosovës, janë nën ndikim të shirave acidik., ujërat e dala nga kanali dhe ato atmosferike qëndrojnë në vite të tëra në ngastrat kadastrale, fotot e bashkëngjitura Raportit shihet se, sipërfaqet e ngastrave të paditësve janë ose plotësisht nën ujë (ngastrat ... dhe ...) ose pjesërisht nën ndikimin e lagështisë së tepërt (ngastra ...). Ndërsa, në seancën e shqyrtimit kryesor eksperti ka deklaruar se: e paditura për nevoja të veta shumë vite më parë e ka devijuar shtratin e lumit dhe punimet të cilat i kanë zhvilluar i kanë zhvilluar pa projekt, rrjedhimisht ka ndryshuar regjimi uJOR ashtu që tani rrjedha e lumit është më afër pronave të paditësve e nga kjo edhe kanali nga ujërat e bardha kalon ka objektet e Kosovës A, deri te përroi i H. . Ekspertiza e hidrologjisë nuk përmban të dhëna të besueshme mbi bazën e të cilave mund të bëhet identifikimin i kanalit, kush e menaxhon, për çka shërben, dhe nëpërmjet cilave parcela kalon.

Ndërsa nga ekspertiza gjeodezike konstatohet se: në pjesën perëndimore të ngastrës kadastrale ... ZK, O. , ishte hapur një kanal, dhe brendësia e ngastrës ishte shndërruar në moqalishte, pastaj se e paditura nuk ka ofruar dëshmi për hapjen e kanalit në këtë ngastër dhe se ky kanal nuk është i paraqitur në planet kadastrale dhe sipas evidencës kadastrale as sipërfaqja e kësaj ngastre nuk ka pësuar ndryshime, ngastër kjo e cila evidentohet në emër të paditësve si bashkëpronar. Ngastra kadastrale ... ZK O. , në sipërfaqe S=..., nuk kishte rrjedhje të ujit nga TC Kosova A, mirëpo ka mbushje me ujë dhe hedhje të mbeturinave, ngastra kadastrale ... ZK O., në sipërfaqe S=..., sipas gjendjes faktike nuk ka rrjedhje të ujit nga kanali i Termocentralit “Kosova A”, por sipas gjendjes faktike ka mbushje dhe hedhje të mbeturinave, kurse sa i përket ngastrës kadastrale . . ZK, O., në sipërfaqe S=..., nuk ka të bëjë me derdhjen e ujërave nga “Kosova A”, por kjo ngastër është në kufi me një kanal të vjetër i cili evidentohet: P. Sh. Ujrat, K. K. O. .

Kështu, gjykata e shkallës së parë ka dështuar të vërtetoj në mënyrë të qartë dhe të plotë gjendjen faktike në terren. Gjukata vë në dukje se eksperti i hidrologjisë i referohet ngastrës kadastrale ..., e cila nuk është objekt shqyrtimi sipas kësaj çështje juridike kontestimore, më pas vëren se eksperti dëmin e shkaktuar ia atribuon: mosmirëmbajtjes së kanalit të dheut, ndryshimit të shtratit të lumit S. dhe kanalit të ujërave të bardha, megjithatë përgjatë elaborimit të mendimit dhe konstatimit të tij i referohet edhe reshjeve atmosferike. Ndërsa, sipas mendimit dhe konstatimit të ekspertit gjeodet, ngastrat kadastrale ... dhe ..., nuk kanë rrjedhje të ujit nga kanali Termocentrali Kosova A, por kanë mbushje me ujë dhe hedhje të mbeturinave, ndërsa ngastra ..., gjendet në afërsi të kanalit P.Sh Ujërat, KK O. .

Ndonëse, ngastra kadastrale ... ZK, O. , evidentohet në emër të paditësve si bashkëpronar, gjykata në aktgjykimin e saj nuk jep sqarime më të detajuara se në çfarë cilësie gjendet e paditura në këtë ngastër, kur i referohet hapjes së kanalit. Mbi prezumimin e gjykatës së shkallës së parë, se kanali në fjalë është hapur nga e paditura, përkatësisht për rrjedhje të ujit nga Termocentrali “Kosova A”, gjykata duhet të vërtetoj edhe kohën e hapjes së tij, përkatësisht nëse periudha e hapjes së kanalit përkon me periudhën e kontestuar nga paditësit

Mbi bazën e kësaj periudhe, duhet të vërtetohen të gjitha rrethanat përcaktuese rreth shkaktimit të dëmit, ngase nuk mjafton vetëm konstatimi se e paditura vite më parë ka bërë ndryshimin e shtratit të lumit S., mirëpo të njëjtat duhet të provohen dhe vërtetohen me prova konkrete, mbi bazën e të cilave duhet të argumentohet secila kërkesë e paditësve. Po ashtu, nëse shkaktimit të dëmit i kanë kontribuar më shumë faktor, atëherë duhet të përcaktohet saktë se: si, në çfarë mënyre dhe nga kush është shkaktuar.

Mbi bazën e refuzimit të pretendimeve ankimore të paditurës nga gjykata e shkallës së dytë ku thekson se: ekspertiza e hidrologjisë përcakton shkaktarin e dëmit, ndërsa ekspertiza e gjeodezisë ka për detyrë të bëjë identifikimin e ngastrave kadastrale, gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë bazuar në konstatimet e ekspertizës gjeodezike e cila ka konstatuar se: ngastra kadastrale nr. ..., nuk ka të bëjë me derdhjen e ujërave nga Kosova A, ka refuzuar kërkesëpadinë që ka të bëjë me fitimin e humbur si të pabazuar, kjo me arsyetimin se përmbytja eventuale e kësaj ngastre nuk ka të bëjë me ujërat e bardha të paditurës, por nga ujërat e kanalit, për të cilën e paditura KEK, nuk mund të mbahet përgjegjëse. Konstatime këto kontradiktore dhe pa koherencë juridike nga gjykatat e instancave më të ulëta.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, është i paqartë edhe në dispozitivin e tij, përkatësisht në pikën I, të tij ku thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë vërtetohet në pikën I, II dhe III, të tij, ndërsa në pikën II, thekson se pika III, e aktgjykimit mbetet e pashqyrtuar.

Në kontekstin e të dhënave të paraqitura rezulton se në këtë rast ka kundërthënie mes provave të paraqitura dhe vendosjes lidhur me çështjen, kjo pasi që nga mënyra si është vendosur nga gjykatat e instancës më të ulët është plotësisht e paqartë se mbi bazën e cilave prova është vërtetuar se e paditura mund të mbahet përgjegjëse për dëmin e shkaktuar paditësve, si rezultat i të cilës do të provohej edhe e drejta e kompensimit të dëmit për fitimin e humbur.

Faktet e tilla janë vendimtare, kjo pasi që nëse paditësit i referohen dëmit të shkaktuar si rezultat i vendosjes së qymyrit në kanalën ku kanë ngushtuar shtratin e lumit “S.”, dhe një përroi që bart ujërat e zeza të O., atëherë procesi gjyqësor duhet orientuar në këtë drejtim në atë mënyrë që të qartësohet se kush, kur dhe si është bërë ngushtimi i shtratit të lumit “S.”, dhe identifikimi i përroit që bartë ujërat e zeza të O. . Në këtë rast, ekspertiza e hidrologjisë dhe ajo e gjeodezisë janë të paqarta dhe kontradiktore me njëra tjetrën, është thelbësore për të vërtetuar nëse dëmi është shkaktuar nga e paditura KEK.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë, të caktoj shqyrtimin kryesor dhe sipas propozimit të palëve, fillimisht të nxjerr prova në drejtim të vërtetimit të fakteve të theksuara më lartë, pastaj nëse është e nevojshme së bashku me palët, apo të autorizuarit e tyre dhe ekspertët të dal në vend, ashtu që gjykata të bëjë përkrahimin e

Numri i lëndës: 2021:020052

Datë: 29.01.2025

Numri i dokumentit: 06774545

gjendjes faktike në terren, dhe pastaj sipas plotësimit të mendimit - raportit me shkrim, gjykata të ndërmerr hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të ketë mundësi që në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësoj rrethanat e çështjes lëndore e pastaj të vendos në mënyrë meritore lidhur me padinë e paditësve dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata sipas revizionit, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 224 paragrafi 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.584/24, të datës 23.01.2025.

Kryetar i kolegjit
Rrustem Thaqi